



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

Nr.regj.them.141 (840)

Data e ardhjes 18.10.2018

Nr. Vendimi 121 (64-2018-1922)

Data e Vendimit 19.10.2018

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Në Lushnje, sot më datë 19.10.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e përbere nga:

GJYQTARE: ESMERALDA XHILI ÇEKA

përfundoi së shqyrtuari, kërkesen penale me nr.regj.them. 141 (840) që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje, e perfaqesuar nga Prokuror Arben Dyla.

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestros mbi llogarinë bankare të përbashkët të shtetasve {xxx} dhe {xxx}, në Bankën {xxx},

BAZA LIGJORE: Neni 210 të Kodit të Procedures Penale.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi u njoh kërkimin e paraqitur, si dhe pasi analizoi provat e marra në seancë gjyqësore dhe vleresoi në tërësi rrethanat e çështjes,

V Ë R E N

I. Procedura:

1. Gjykata, pasi u njoh me kërkesen vlerëson se shqyrtimi i saj është në juridiksionin dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Shqyrtimi i kërkesës u bë duke respektuar ligjin procedural penal.

II. Faktet e rezultuara:

2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka regjistruar në datë 18.10.2018, aktet e procedimit penal nr.687, për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve {xxx} dhe {xxx}. Sa më lart, është bërë mbi bazën e akteve të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Fier.

Nga aktet e procedimit ka rezultuar se nga Sektori kundër Krimin Ekonomik dhe Financiar ne Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier, është marrë informacion në lidhje me aktivitetin ekonomik

të shtetasve {xxx} dhe {xxx}. Nga të dhënat e marra, ka rezultuar se shtetësja {xxx} ka kryer depozitime të larta në cash, me burim fondesh të deklaruara nga emigracioni në Itali. Në muajin gusht 2017, kjo shtetase ka hapur llogari të përbashkët bankare me babanë e saj, shtetasin {xxx}, në monedhën euro, me gjendje aktuale 177 451 euro në bankën {xxx}. Gjithashtu shtetasi {xxx} ka patur një llogari individuale në euro, të hapur në datë 07.12.2016 me nr. {xxx}, ku janë kryer një sërë transaksionesh. Shtetasi {xxx} ka edhe dy depozita individuale në lek nr {xxx} me gjendje 300 000 lekë dhe depozitë nr. {xxx} me gjendje 400 410 lekë.

3. Shtetësja {xxx} ka disa deklarata mbi fitimet e saj vjetore nga puna për vitet 2005-2007, 2009, 2011-2013, 2015-2017, ku fitimet ndër vite, arrijnë vlerat 14 832 euro, 6 338 euro, 6 543 euro, 6 897 euro, 34 777 euro, 32 459 euro, 32 808 euro, 34 211 euro, 72 988 euro, në total vlerën prej 241 853 euro. Në dhjetor të vitit 2016, ka regjistruar subjektin {xxx} Itali me objekt "Tregti, shitje pijesh, ushqimesh etj.". Shtetësja {xxx} është ortakë me 50 % dhe bashkëortakë janë prindërit me 25 % secili; {xxx} dhe {xxx} dhe administratore {xxx}. Ky subjekt ka aktivitet të gjerë, por aktiviteti kryesor është "bar restorant". Kapitali themeltar 10 000 euro.

4. Nga verifikimi në burime të hapura për shtetasit {xxx} kanë rezultuar të dhëna me interes për shtetas me gjeneralitete {xxx} dhe {xxx}, si më poshtë: për shtetasin {xxx} rezulton një artikull ku është pjesë e grupit të arrestuar në Itali në datë 04.05.2014, si korrier droge. Nuk jepen të dhëna individualizuese por artikulli thotë se është kosovar. Me herët në 2008 rezulton edhe një lajm tjetër për {xxx}, përsëri si korrier droge. Ndërsa për shtetasen {xxx} rezulton të jetë e lidhur me mafian italiane {xxx}. Përsa me sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave me shkresën nr. 1999/2 prot. Datë 16.10.2018 i ka përcjellë Bankës {xxx} urdhërin nr.87 datë 16.10.2018 me anë të të cilit ka vendosur bllokimin e përkohshëm të llogarive bankare dhe çdo transaksioni të kryer në emër dhe për llogari të shtetasve {xxx}, e datëlindjes {xxx} dhe {xxx}, i datëlindjes {xxx}.

5. Në këto kushte, Prokuroria ka paraqitur kërkesën në Gjykatë me arsyetimin se ka arsye të bazuara në prova se sasia prej 177 451 euro e depozituar në bankën {xxx} vjen nga aktivitet kriminal dhe për këtë arsye sipas nenit 210 të K.Pr.Penale, Prokuroria paraqet kërkesën për vënien e sekuestros konservative mbi llogarinë bankare të përbashkët të shtetasve {xxx} dhe {xxx} në bankën {xxx} me nr. {xxx}, në monedhën euro dhe me gjendje aktuale në shumën 177 451 euro.

III.Arsyetimi i Gjykatës:

6. Neni 210 i K.Pr.Penale përcakton se: "Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjë tjetër, edhe nëse gjenden në kasetën e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i perkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme, ky vendim mund të merret nga Prokurori".

7. Në kuadër të nevojës për të penguar vijimësinë e veprimtarisë kriminale, në K.Pr.Penale ka gjetur pasqyrim mundësia e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit, jo vetëm në aspektin personal, por njëkohësisht edhe në atë të të drejtave pasurore. Në këtë aspekt, legjislatori ka parashikuar institutin e masave të sigurimit pasuror, në kategorinë e të cilave bën pjesë edhe sekuestro preventive. Neni 274 i K.Pr.Penale përcakton së sekuestro preventive urdhërohet në

rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera (neni 274/1). Gjithashtu, sekuestro preventive mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal (neni 274/2). Në rastin e parë, objekti i sekuestros preventive përbëhet nga "sendet që lidhen me veprën penale", domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e metëjshme e sendit. Ndërkohë, në rastin e dytë, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal. Në çdo rast, caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive kushtëzohet nga ekzistenca e njëkohshme e elementeve të mëposhtem: prania e indicieve dhe rreziku i vonesës deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar.

8. Është e kuptueshme se për zbatimin e sekuestros preventive, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuese rreth kryerjes (ose kryerjes së mundshme në të ardhmen e afërt) se një fakti që përbën vepër penale të parashikuar dhe të cilësuar në bazë të një dispozite të Kodit Penal. Përsa i takon rrezikut të vonesës, Gjykata vlereson se rreziku i vonesës nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një mundësi reale, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht.

9. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata konstaton se ekziston dyshimi i arsyeshëm se pasuria për të cilën kërkohet vendosja e sekuestros është rezultat i veprimtarisë kriminale dhe konkretisht produkt i veprës penale të "*Pastrim i produkteve të veprës penale*", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në kushtet kur kjo pasuri ndodhet nën rrezikun potencial të tjetërsimit të vazhdueshëm, Gjykata konkludon se disponimi i lirë i saj mund të rëndojë apo të zgjasë më tepër pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Rrjedhimisht, Gjykata krijon bindjen se ekziston rreziku që disponimi i lire i pasurisë për të cilën është kërkuar vendosja e sekuestros preventive, të rëndojë apo zgjasë pasojat e veprës penale. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje është e bazuar në ligj dhe në prova, e si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në nenet 210 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje.
- Vendosjen e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të përbashkët të shtetasve {xxx} dhe {xxx} në Bankën {xxx} me nr. {xxx}, në monedhën euro dhe me gjendje aktuale në shumën 177 451 euro.

- Ngarkohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe policia gjyqësore (*oficeri I policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Fier, Z. {xxx}*) për zbatimin e këtij vendimi.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.
Lushnjë në datë 19.10.2018.

G J Y Q T A R E

Esmeralda XHILI (ÇEKA)